

RBI: Raporti i tremujorit të parë 2022

Fitimi i konsoliduar shënoi vlerën 442 milionë euro me një qasje të kujdeshme ndaj kostove të rrezikut.

- Të ardhurat neto nga interesi u rritën me 1% krahasuar me një tremujor më parë, duke përfituar nga normat më të larta në të gjithë rajonin.
- Të ardhurat neto nga tarifatat dhe komisionet u rritën me 22% krahasuar me një tremujor më parë, të nxitura kryesisht nga rritja e aktivitetit të klientëve në biznesin FX në Rusi.
- Të ardhurat neto nga tregtimi në vlerën 184 milionë euro, kryesisht nga instrumentet mbrojtëse dhe diferencat e veta të kredisë që lidhen me biznesin e certifikatave.
- Raporti i provigjionimit krahasuar me një vit më parë u rrit ndjeshëm në 0.97%, kryesisht i nxitur nga uljet makro dhe faktorët e veçantë të rrezikut për shkak të luftës në Ukrainë.
- Kreditë u rritën me 1% në tremujorin e parë dhe kreditimet e reja në Rusi kryesisht janë ndalur.
- Fitimi i konsoliduar është përmirësuar me 39% krahasuar me një tremujor më parë, në vlerën 442 milionë euro.
- Raporti CET1 shënoi 12.3% (i përkohshëm, duke përfshirë rezultatin krahasuar me një vit më parë), duke reflektuar rritjen e RWA nga ulja e vlerësimit në Rusi, Ukrainë dhe Bjellorusi.
- Kjo përmbledhje është përditësuar duke reflektuar rritjen më të ulët të kredive dhe supozimet më të larta të kostos së rrezikut.

Pasqyra e të Ardhurave në milionë EUR	T1/2022	T1/2021	T4/2021
Të ardhura Neto nga Interesat	986	736	976
Të ardhurat neto nga tarifatat dhe komisionet	683	420	561
Të ardhura neto nga tregtimi dhe rezultati i vlerës së drejtë	184	4	24
Shpenzime të përgjithshme administrative	(792)	(672)	(856)
Rezultate operative	1089	543	763
Rezultate të tjera	(102)	(38)	(175)
Masat qeveritare dhe kontributet e detyrueshme	(159)	(123)	(32)
Humbjet nga zhvlerësimi nga aktivet financiare	(319)	(76)	(150)
Fitimi/humbja para taksave	508	306	406
Fitimi/humbja përpara taksave nga operacionet e vazhdueshme	440	229	329
Fitimi/humbja nga operacionet e ndërprera	18	14	24
Fitimi i konsoliduar	442	216	317
Bilanci në milionë EUR	31/03/2022	31/12/2021	
Kredi ndaj konsumatorëve	101966	100832	
Depozita nga klientët	113652	115153	
Totali i aktiveve	192624	192101	

Totali i asetëve të ponderuara ndaj riskut (RWA)	104017	89928
--	--------	-------

Raportet kyçe	31/03/2022	31/12/2021
Raporti NPE	1,6%	1,6%
Raporti i mbulimit të NPE (%)	61,8%	62,5%
Raporti CET1 (përfshirë rezultatet)	12.3%*	13,1%
Totali i raportit të kapitalit (përfshirë rezultatet)	15.9%*	17,6%

*E përkohshme

Raportet kyçe	T1/2022	T1/2021	T4/2021
Marzhi i interesit neto (mesatarja e asetëve me interes)	2,21%	1,92%	2,22%
Raporti kosto/të ardhura	42,1%	55,3%	52,9%
Raporti i huadhënies (mesatarja e kredive ndaj konsumatorëve)	0,97%	0,36%	0,55%
Kthimi i konsoliduar mbi kapitalin	13,2%	6,5%	10,1%
Fitimi për aksion në EUR	1,27	0,59	0,90

Për shkak të shitjes së planifikuar të bankës filial në Bullgari dhe pjesëmarrjes së saj, ka pasur një ndryshim në pasqyrat financiare sipas SNRF 5. Ky operacion biznesi klasifikohet si një grup në shitje dhe raportohet veçmas në pasqyrën e pozicionit financiar. Shifrat e vitit të kaluar nuk janë përshtatur ende. Pasqyra e të ardhurave e bankës filial në Bullgari dhe pjesëmarrja e saj raportohet nën zërin e fitim/humbje nga operacionet e ndërprera. Shifrat e vitit 2021 janë përshtatur në përputhje me standardet në pasqyrën e të ardhurave, dhe po ashtu edhe raportet kryesore.

Përmbledhje

Në vitin 2022, të ardhurat neto nga interesi pritet të rriten me përqindje të lartë njëshifrore dhe të ardhurat neto nga tarifatat dhe komisionet në intervalin mesatar me një shifër.

Presim vëllime të qëndrueshme kredie në vitin 2022, me rritje mesatare njëshifrore në tregjet bazë të EQ dhe EQL.

Presim rritje të lartë njëshifrore në përqindje të OPEX plus një kosto shtesë integrimi rreth 100 milionë euro për blerjet në Republikën Çeke (Equa bank) dhe në Serbi (Crédit Agricole Srbija).

Raporti kosto/të ardhura pritet të jetë rreth 55 %.

Raporti i provigjonimit për vitin 2022 pritet të jetë deri në 100 pikë bazë.

Kthimi i konsoliduar nga kapitali pritet të jetë në intervalin 8 deri në 10 përqind.

Në vitin 2022, presim që raporti CET1 të rikuperohet më pranë objektivit tonë prej 13 për qind.

Objektivat afatmesëm të kthimit të kapitalit dhe të raportit të pagesës janë pezulluar për shkak të pasigurive aktuale në Evropën Lindore.

* * * * *

RBI i referohet Austrisë, ku është një bankë lider për korporata dhe investime, si dhe në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL) si treg mëmë. 13 tregje në këtë rajon mbulojnë nga filialet e bankës. Për më tepër, Grupi RBI përfshin edhe ofrues të tjerë të shumtë të shërbimeve financiare, për shembull për qiratë financiare (leasing), menaxhimin e asetëve ose Bashkime & Blerje (M&A).

Rreth 47 000 punonjës u shërbejnë mbi 18 milionë klientëve në përafërsisht 1800 degë, duke mbuluar kështu pjesën më të madhe të territorit të EQL. Aksionet e RBI janë të listuara në Bursën e Vienës. Bankat Rajonale Austriake Raiffeisen zotërojnë rreth 58,8 përqind të aksioneve, ndërsa pjesa tjetër operojnë të pavarura. Brenda Grupit Bankar Raiffeisen në Austri, RBI është instituti qendror i Bankave Rajonale Raiffeisen dhe institucioneve të tjera të lidhura të kreditit.

**Press
Release**



Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni:
Ingrid Ditz (+43-1-71 707-6055, ingrid.ditz@rbinternational.com) ose
Christof Danz (+43-1-71 707-1930, christof.danz@rbinternational.com)
<http://www.rbinternational.com>